

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 16-22.12.2024

Janë testuar gjithsej 109 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=87) është shënuar një rënie prej 25,3%.

Nuk janë regjistruar raste pozitive.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 16-22.12.2024

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
16.12.2024	17	0	0,0%
17.12.2024	23	0	0,0%
18.12.2024	14	0	0,0%
19.12.2024	21	0	0,0%
20.12.2024	18	0	0,0%
21.12.2024	3	0	0,0%
22.12.2024	12	0	0,0%
Gjithsej	109	0	

Gjatë javës së kaluar (16-22.12.2024), nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

Për momentin nuk ka raste aktive me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

gjendja kumulative me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Gjatë vitit 2024, deri më 22.12.2024, janë regjistruar gjithsej 1.746 raste me COVID-19. Në muajin nëntor të vitit 2024 (12) regjistrohet një rënie prej 78,6% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 22.12.2024, janë testuar gjithsej 13.163 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

VLERËSIMI I RREZIKUT

Pas një periudhe aktiviteti shumë të ulët, detektohet një rritje e aktivitetit të SARS-CoV-2 brenda kontinentit evropian, përfshirë edhe në R. e Maqedonisë së Veriut. Në dy muajt e fundit regjistrohet një rënie e numrit të rasteve pozitive, por edhe i numrit të testimeve.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 23.12.2024

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>